



Spitali Katolik Zoja e Këshillit të Mirë

PËRKUSHTUAR SHËNDETIT

RREGULLORE E PËRGJITHSHME

Tiranë, Qershor 2022

Përmbajtja

Neni 1 - Emërtesa	3
Neni 2 – Qëllimi, vizioni, misioni	3
Neni 3 – Vlerat e përgjithshme në menaxhimin e Spitalit ZKM	3
Neni 4 – Vlerat dhe parimet profesionale të Spitalit ZKM	4
Neni 5 - Objektivat strategjike	5
Neni 6 - Bashkëpunimi me Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”	5
Neni 7 – Logo dhe vula	6
Neni 8 - Selia dhe degët	6
Neni 9 - Burimet kapitale dhe burimet e financimit	6
Neni 10 - Organet drejtuese të spitalit	6
Neni 11 - Këshilli i Administrimit	7
Neni 12 - Thirrja dhe Mbledhjet e Këshillit të Administrimit	7
Neni 13 - Kompetencat e Këshillit të Administrimit	8
Neni 14 – Grupi Drejtues	8
Neni 15 - Funkcionet e Drejtorit të Përgjithshëm	9
Neni 16 - Drejtori Mjekësor	10
Neni 17 - Drejtori Administrativ	12
Neni 18 - Koordinator i përgjithshëm (Kryeinfermieri i Përgjithshëm)	14
Neni 19 - Këshilli i Etikës	14
Neni 20 – Këshilli Shkencor	15
Neni 22 - Dispozitat përfundimtare	16

Neni 1 - Emërtesa

Spitali “Zoja e Këshillit të Mirë” (në formë të shkurtuar: Spitali ZKM) është themeluar nga Fondacioni “Zoja e Këshillit të Mirë” (në formë të shkurtuar FZKM), me seli në Tiranë, Rruga “Dritan Hoxha”, nr. 120, Tiranë, në zbatim të ligjit nr.8608, datë 27.04.2000 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Katolike në Shqipëri “Për Ndërtimin dhe Administrimin e Spitalit “Zoja e Këshillit të Mirë. Spitali ZKM është një spital universitar dhe me frymëzim katolik.

Neni 2 – Qëllimi, vizioni, misioni

- 1) Spitali ZKM, pa qëllime fitimi, funksionon si njësi organizative e Fondacionit ZKM me synimin për të ofruar ndihmë shëndetësore dhe shpirtërore për të sëmurët, në përputhje me objektivat e përcaktuar nga i Lumi Luigji Monti.
- 2) Spitali ZKM nga njëra anë ndjek përmirësimin e shërbimeve shëndetësore nëpërmjet aplikimit të arritjeve më të avancuara shkencore dhe teknologjike, nga ana tjetër përkrah zhvillimin e kërkimit dhe transferimin e rezultateve të arritura në shërbim të së mirës së përbashkët.
- 3) Spitali ZKM siguron përdorimin sa më efektiv të burimeve të disponueshme për të ndjekjen e veprimtarive institucionale, duke siguruar transparencën e kritereve dhe procedurave të vendimmarrjes.
- 5) Spitali ZKM ka si vizion t’i shërbejë jetës dhe shëndetit të individëve “me shkencë dhe përkushtim”.

Neni 3 – Vlerat e përgjithshme në menaxhimin e Spitalit ZKM

- 1) Spitali ZKM vepron për të mbrojtur dhe zhvilluar dinjitetin e njeriut. Parimi më i lartë udhëheqës është respekti për shenjtërinë e çdo jete njerëzore, që nga çasti i ngjizjes së saj e deri në vdekje. Jeta, si e drejta e parë e një qenieje njerëzore, nënkupton edhe të drejtën e pasjes së mundësive për zhvillimin normal të saj, çka përfshin edhe një përkujdesje të përshtatshme shëndetësore.
- 2) Spitali ZKM angazhohet të luajë një rol të rëndësishëm në kujdesin shëndetësor të njerëzve në nevojë, të personave vulnerabël dhe të pambrojtur, duke zhvilluar format e veta të pjesëmarrjes në kostot e menaxhimit në frymën e mëshirës, duke shpresuar për një marrje të drejtë të përgjegjësisë edhe nga institucionet publike në respektimin e të drejtës për shëndetin e çdo qytetari.
- 3) Spitali ZKM është në shërbim të së mirës publike. Duke kontribuar në shëndetin fizik dhe shpirtëror të njerëzve, ai luan një rol të rëndësishëm në favor të prosperitetit dhe zhvillimit të Shqipërisë.
- 4) Spitali ZKM ndihet i përkushtuar për të ndjekur një menaxhim të qëndrueshëm etik të aktivitetit të kujdesit, duke marrë parasysh si situatën e të sëmurëve ashtu edhe burimet e veta në dispozicion. Për këtë qëllim, ai është aktiv në mobilizimin dhe inkurajimin e aktorëve të tjerë publikë dhe privatë për të kontribuar në kostot e menaxhimit, në mënyrë që të gjenerojë burimet e nevojshme për të ofruar shërbime shëndetësore sa më të përshtatshme.
- 5) Duke funksionuar në një shoqëri pluraliste, Spitali ZKM mund të përballet me kërkesa, procedura dhe praktika shëndetësore ose ekonomike, që nuk janë në përputhje me Doktrinën e Kishës Katolike.

Spitali refuzon të marrë pjesë në iniciativa ose të miratojë procedura që janë të huaja për vlerat morale të Kishës Katolike. Ky angazhim etik vlen si për shërbimet shëndetësore ashtu edhe për kërkimin.

6) Spitali ZKM zbaton parime, standarde dhe procedura menaxhuese e administruese që sigurojnë funksionimin efektiv dhe efikas të shërbimeve të tij.

7) Si një spital me frymëzim katolik, spitali ZKM është një bashkësi profesionistësh të dedikuar ndaj shëndetit, që nuk kufizohet vetëm me trajtimin e sëmundjes apo lehtësimin e vuajtjes trupore, por angazhohet në kuadër të një qasjeje gjithëpërfshirëse, duke adresuar edhe aspektet psikologjike, sociale dhe shpirtërore të pacientëve dhe të atyre që u shërbejnë. Përkujdesja shpirtërore katolike ndaj personelit apo pacientëve që e kërkojnë atë është një ndër shërbimet specifike që ofrohen në Spitalin ZKM.

8) Mes profesionistëve që ofrojnë shërbime shëndetësore dhe atyre që kanë nevojë për to, në Spitalin ZKM, synohet të krijohet një marrëdhënie njerëzore, e bazuar në respektin reciprok, besim, ndershmëri dhe konfidencialitet. Një klimë e pastër dhe e hapur komunikimi, e çliruar nga droja e manipulimit, intimidimit apo e shpërfilljes, është kusht paraprak për shkëmbimin e lirshëm të informacionit, që është me rëndësi themelore për të mundësuar një efektivitet të lartë të profesionistëve të shëndetit.

9) Një element i rëndësishëm i komunikimit mjek-pacient, është informimi i plotë i pacientit lidhur me gjendjen dhe perspektivën e trajtimit shëndetësor. Miratimi i pacientit është kusht paraprak për aplikimin e procedurave, terapive të nevojshme. Në raste të veçanta miratimi mund të jepet nga familjarët apo nga figura të tjera të autorizuara dhe mund edhe të përjashtohet në kushte të urgjencave mjekësore.

10) Duke patur qëllimi kryesor mbrojtjen e jetës dhe dinjitetit njerëzor, Spitali ZKM nxit dhe përdor përparimin e shkencës dhe teknologjisë, duke dalluar sipas parimeve të moralit të krishterë, për të mbrojtur jetën e personit në të gjitha rrethanat dhe, veçanërisht, në shtetet fqinjë. Vetëvraska dhe eutanazia janë të papranueshme për vlerat e mbajtura nga spitali. Krahas dispozitave bazë të kësaj rregulloreje, aspektet etike të veprimtarisë së Spitalit ZKM rregullohen në Kodin e tij të Etikës, zbatimin e të cilit e mbikqyr Këshilli i Etikës.

Neni 4 – Vlerat dhe parimet profesionale të Spitalit ZKM

Angazhimi kryesor i Spitalit ZKM është ekselenca e shërbimit që arrihet nëpërmjet investimit tek burimet e tij njerëzore dhe te zbatimi i praktikave të mira, të frymëzuara te vlerat themelore e mëposhtme:

1) **Shërbimi:** me përkushtim, me pasion dhe ndjeshmëri ndaj pacientëve është elementi kryesor që shënjon profilin operativ të spitalit dhe karakteristikat bazë të tij.

2) **Përgjegjshmëria:** si përgjigje serioze kundrejt një nevoje, shprehje e një ndjenjeje të ndarë me të tjerët, për të krijuar besim të ndërsjellë ndërmjet të sëmurëve, operatorëve sanitarë dhe familjeve në shumëllojshmërinë e raporteve që zhvillohen mes atyre që shërbejnë dhe atyre që marrin shërbime.

3) **Respekti:** një qëndrim i përgjegjshëm ndaj dinjitetit njerëzor të çdo personi, i pakushtëzuar nga gjinia, moshë, statusi shoqëror, etnia, raca, besimi fetar apo dallime të tjera.

4) **Ekselenca:** bëhet fjalë për një vlerë profesionale që synohet, qoftë si mjet i domosdoshëm, dhe si rezultat i qasjes së përgjithshme të spitalit për të vënë në shërbim të njerëzve arritjet më të fundit të shkencës dhe të teknologjisë.

5) **Sinergjia:** Spitali bazohet tek ekipet bashkëpunuese të cilat nuk krijojnë një klimë favorizuese për frymën egoiste apo konkurrencat e ndërsjella.

6) **Paanshmëria:** të gjithë strukturat e Spitalit ZKM, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre do trajtojnë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjithë subjektet me të cilët krijojnë marrëdhënie në përputhje me këtë rregullore dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fushën e shërbimeve ndaj njeriut.

7) **Neutraliteti:** në ushtrimin e funksioneve të tyre, përfaqësuesit dhe bashkëpunëtorët e Spitalit ZKM duhet të kenë një qasje objektive dhe të vetëdijshme për kompleksitetin e situatave, duke shmangur ushqyerjen e një klime mosmarrëveshjeje midis pacientëve, kolegëve apo institucioneve, veçanërisht për çështje ideologjike.

8) **Barazia dhe mosdiskriminimi:** është angazhimi për të trajtuar të gjithë në mënyrë të barabartë.

9) **Integriteti** si standard që mundëson kryerjen e detyrës me ndershmëri, me zell dhe me përgjegjësi, duke respektuar vlerat, parimet profesionale, legjislacionin dhe kërkesat e akteve të tjera që rregullojnë veprimtarinë e Spitalit ZKM.

Neni 5 - Objektivat strategjike

1) Për arritjen e qëllimeve institucionale, Spitali ZKM fokuson veprimtaritë e tij menaxhuese në arritjen e objektivave të mëposhtëm:

- a) zbatimin e parimit të pacientit në qendër të vëmendjes.
- b) zhvillimin e vazhdueshëm të përmbajtjes shkencore dhe klinike të shërbimeve shëndetësore.
- c) kërkimin e përsosmërisë në cilësinë e shërbimeve spitalore.
- d) vazhdimësinë e përditësimit dhe trajnimit të punonjësve.
- e) arritjen e barazimit të bilancit.

Neni 6 - Bashkëpunimi me Universitetin Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë"

1) Spitali ZKM e kryen aktivitetin në bashkëpunim të ngushtë me Universitetin Katolik ZKM (UKZKM) nëpërmjet marrëveshjeve specifike. Ai kryen kërkime klinike në bashkëpunim me departamentet e Fakulteteve të UKZKM.

2) Spitali dhe Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë" funksionojnë si dy mushkëri të të njëjtit trup, duke lejuar kështu integrimin natyral midis praktikës klinike dhe kërkimit si pjesë e një procesi të vetëm. Në funksion të këtij integrimi organik, ata planifikojnë dhe zbatojnë programe të përbashkëta, duke respektuar dinjitetin njerëzor dhe rigorozitetin shkencor. Pedagogët dhe studentët e Universitetit përfshihen në veprimtarinë klinike të spitalit dhe personeli mjekësor i tij mund të përfshihet në aktivitetet mësimore të Universitetit.

Neni 7 – Logo dhe vula

- 1) Logo e Spitalit ZKM është në formë ovale, me ngjyrë blu në sfond të bardhë, ku paraqitet Nëna e Krishtit me emërtimin “Zoja e Këshillit të Mirë”, e adhuruar prej shekujsh në Shkodër (Shqipëri) me fëmijën Jezus në krahë. Në pjesën e sipërme ka mbishkrimin latin “HOSPITALIS MATER BONI CONSILII”; në fund, e ndarë nga lart me dy yje të verdhë, është shkruar në latinisht motoja e Spitalit ZKM "*Rinovabit sicut aquilae*".
- 2) Vula e spitalit ZKM përbëhet nga logo e spitalit në formën e një rrethi.

Neni 8 - Selia dhe degët

- 1) Spitali ZKM operon në:
 - a) Selia parësore në Tiranë, Rruga “Dritan Hoxha” Nr. 123.
 - b) Selia dytësore në Tiranë, Rruga e Kavajës Nr.120 (selia e Poliambulancës "Atë Luigji Monti"), si strukturë plotësuese e Spitalit ZKM.

Neni 9 - Burimet kapitale dhe burimet e financimit

- 1) Infrastruktura fizike dhe pajisjet e vëna në dispozicion të SPITALIT ZKM janë në pronësi të Fondacionit Zoja e Këshillit të Mirë.
- 2) Spitali ZKM funksionon në thelb sipas kriterëve të vetë-qëndrueshmërisë. Burimet e financimit për Spitalin ZKM janë:
 - a) fondet e destinuar nga Fondacioni ZKM për themelimin dhe fillimin e veprimtarisë së Spitalit ZKM;
 - b) tarifat në fuqi, të cilat do të mblidhen nga shërbimet e ndryshme mjekësore në përputhje me legjislacionin përkatës;
 - c) financimi i paketave shëndetësore të dakordësuara me strukturat e sistemit kombëtar shëndetësor (FSDKSH) sipas marrëveshjes përkatëse.
 - d) financimet e marra nga subjekte publike dhe private me karakter vendor, rajonal, kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar;
 - e) financime dhe grante në zbatimin e projekteve të ndryshme;
 - f) të ardhurat e realizuara në kuadër të kërkimit shkencor;
 - g) donacionet, trashëgimitë dhe të ardhura të tjera të dhëna nga bamirësit, qofshin këta persona fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj.

Neni 10 - Organet drejtuese të spitalit

- 1) Organet drejtuese të spitalit janë:
 - a. Këshilli i Administrimit;

- b. Grupi Drejtues;
- c. Këshilli i Etikës.
- d. Këshilli Shkencor

Neni 11 - Këshilli i Administrimit

- 1) Spitali ZKM drejtohet nga Këshilli i Administrimit, i cili është edhe organi më i lartë drejtues dhe ekzekutiv i tij.
- 2) Këshilli i Administrimit të spitalit, deri në vendimmarrje të tjera, është Këshilli i Administrimit të Fondacionit ZKM.
- 3) Drejtori i Përgjithshëm merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të Administrimit pa të drejtë vote, për çështje që kanë të bëjnë me spitalin. Sipas marrëveshjes përkatëse institucionale, mund të kooptohet një përfaqësues i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSKSH)
- 4) Këshilli i Administrimit është një organ drejtues që ndërmerr politikën në nivel qendror lidhur me drejtimin dhe vendimmarrjen, financat, investimet dhe perspektivën e Spitalit ZKM. Këshilli kujdeset për respektimin e legjislacionit në fuqi, standardeve të shërbimit spitalor dhe ushtron rolin kontrollues të mbikëqyrës për zbatimin e këtyre politikave.

Neni 12 - Thirrja dhe Mbledhjet e Këshillit të Administrimit

- 1) Këshilli i Administrimit thirret nga Presidenti ose, me delegimin e tij me shkrim, nga Zëvendës Presidenti me anë të një njoftimi që përmban rendin e ditës, datën, orën dhe vendin, i cili mund të jenë i ndryshëm nga ajo e selisë.
- 2) Drejtori i Përgjithshëm i Spitalit ZKM mund të kërkojë në mënyrë të jashtëzakonshme thirrjen e mbledhjes së Këshillit, të Administrimit.
- 3) Anëtarët e Këshillit të Administrimit, si rregull, njoftohen pesëmbëdhjetë ditë përpara mbledhjes së Këshillit. Në rastet e gjykuara urgjente nga Presidenti, Këshilli mund të thirret në mënyrë të shpejtë me mjetet që konsiderohen më të përshtatshme dhe të afta për të inkurajuar pjesëmarrjen e të gjithëve, qoftë edhe virtualisht.
- 4) Mbledhjet e Këshillit të Administrimit konstituohen në mënyrë të vlefshme me praninë e shumicës së anëtarëve të tij në detyrë, këta nuk mund të përfaqësohen.
- 5) Këshilli mund të thërrasë në mbledhjet e tij drejtuesit dhe/ose specialistët e spitalit, ose ekspertë të tjerë të jashtëm, për çështje të ndryshme.

Neni 13 - Kompetencat e Këshillit të Administrimit

1) Këshilli i Administrimit ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) përcakton planet strategjike dhe politikat e zhvillimit.
- b) miraton politikat, programet tekniko-financiare për zbatimin e planeve afatshkurtër dhe afatgjatë në fushën e zhvillimit të Spitalit ZKM, në përputhje me strategjitë dhe politikat e Fondacionit ZKM;
- c) është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit përkatës në fushën shëndetësore;
- d) mbikëqyr dhe kontrollon drejtimin e spitalit;
- e) është përgjegjës për cilësinë e shërbimit;
- f) miraton organigramën e Spitalit ZKM dhe ndryshimet e mundshme;
- g) miraton projektbuxhetin;
- h) miraton bilancin faktik vjetor;
- i) vendos për pranimin e dhuratave nga individë ose organizata për qëllime bamirësie, si dhe lidhur me marrëveshjet me spitalet e tjera;
- j) emëron dhe shkarkon Drejtorin e Përgjithshëm të Spitalit ZKM;
- k) emëron dhe shkarkon Drejtorin mjekësor dhe Drejtorin administrativ të Spitalit ZKM, edhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm;
- l) kontrollon dhe miraton zbatimin e Rregulloreve të brendshme dhe procedurave të aplikimeve;
- m) miraton planin tre-vjeçar të Spitalit ZKM të paraqitur nga Drejtori i Përgjithshëm;
- n) udhëzon Drejtorin e Përgjithshëm të spitalit për të negociuar me FSKSH draftin e kontratës, dhe në vijim bën miratimin e saj.
- o) kryen kontroll dhe mbikëqyrje mbi veprimtarinë e Spitalit nëpërmjet figurave profesionale të brendshme apo të jashtme.

Neni 14 – Grupi Drejtues

1) Grupi Drejtues i Spitalit ZKM është një organ kolegjal dhe ekzekutiv. Grupi Drejtues i Spitalit ZKM përbëhet nga:

- a) Drejtori i Përgjithshëm;
- b) Drejtori Mjekësor
- c) Drejtori Administrativ
- d) Koordinatorin e përgjithshëm (Kryeinfermieri i Përgjithshëm)

2) Funkcionet kryesore të Grupit Drejtues janë:

- a) Të japë orientime mbi strukturën organizative të Spitalit ZKM.
- b) Të japë orientime mbi kategoritë e pagave për të gjitha funksionet organike të Spitalit ZKM.
- c) Të japë orientime mbi politikat dhe strategjitë e Spitalit ZKM.
- d) Të përcaktojë tarifat për shërbimet spitalore që ofrohen nga Spitalit ZKM.
- e) Të japë sugjerime për rishikimin dhe aplikimin e rregulloreve të brendshme të Spitalit ZKM.

3) Emërimi i drejtorëve ose specialistëve që kanë interesa në spitale publike ose jo publike (konflikti i mundshëm i interesit sipas ligjit), nuk lejohet brenda Grupit Drejtues të Spitalit ZKM.

Neni 15 - Funkcionet e Drejtorit të Përgjithshëm

1) Këshilli i Administrimit, me emërim me shkrim të posaçëm, i delegon përgjegjësitë e menaxhimit të Spitalit ZKM Drejtorit të Përgjithshëm. Marrëdhëniet ndërmjet Këshillit të Administrimit dhe Drejtorit të Përgjithshëm rregullohen me nënshkrimin e një kontrate individuale e cila mund të përsëritet apo zgjatet me apo pa kritere të reja. Kontrata përcakton objektiva specifike, si dhe detyrat e përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm, ose thjesht i referohet kësaj Rregulloreje.

2) Drejtori i Përgjithshëm drejton, koordinon dhe është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë dhe menaxhimin Spitalit ZKM, sipas linjave udhëzuese dhe programuese të vendimeve të marra nga Këshilli i Administrimit të Fondacionit ZKM. Ai do të raportojë për të gjithë veprimtarinë tek Presidenti i Këshillit të Administrimit, me të cilin koordinohet për zbatimin e masave të kompetencës së tij.

3) Drejtori i Përgjithshëm i Spitalit ZKM përgjigjet solidarisht, në përputhje me ligjin, me antarët e tjerë të Grupit Drejtues për aktet e miratuara nga Këshilli i Administrimit.

4) Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson Spitalin ZKM me kompetenca nënshkrimi mbi aktet që i përkasin administrimit të zakonshëm. Drejtori i Përgjithshëm mund t'i delegojë disa kompetenca tek drejtuesit sipas dispozitave të përfshira në rregulloret specifike të miratuara nga Këshilli i Administrimit.

5) Drejtori i Përgjithshëm ushtron funksionet e mëposhtme:

- a) përfaqëson Spitalin ZKM në marrëdhëniet me të tretët sipas kompetencave dhe të drejtave të përcaktuara në këtë Rregullore;
- b) përgjigjet përpara Këshillit të Administrimit për funksionimin dhe mbarëvajtjen e Spitalit.
- c) promovon, në marrëveshje me Presidentin e Këshillit të Administrimit, çdo veprim të dobishëm për të siguruar dhe zhvilluar dimensionin etik të Spitalit ZKM, duke iu referuar trashëgimisë historike dhe shpirtërore të Fondacionit ZKM.
- d) nxjerr urdhra dhe dekrete të brendshme për funksionimin korrekt dhe mbarëvajtjen e punës së spitalit, në përputhje me këtë Rregullore;
- e) raporton dhe i përgjigjet Këshillit të Administrimit të paktën dy herë në vit dhe paraqitet kur i kërkohet zyrtarisht;
- f) ndjek zbatimin e treguesve shëndetësorë dhe ekonomikë të Spitalit ZKM;
- g) përgatit planet e punës dhe buxhetin në fillim të vitit dhe ia paraqet për miratim Këshillit të Administrimit;
- h) miraton në fillim të vitit planet e punës të propozuara nga drejtuesit kryesorë të Spitalit ZKM.
- i) kryeson dhe menaxhon Grupin Drejtues;
- j) harton detyra të veçanta për drejtorin shëndetësor dhe drejtorin administrativ;
- k) miraton detyrat për të gjithë punonjësit e Spitalit ZKM;
- l) punëson dhe shkarkon, pasi ka marrë mendimin e Grupit Drejtues, personelin mjekësor dhe personelin administrativ, me propozim të Drejtorit Mjekësor dhe Drejtorit Administrativ sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë. Është gjithashtu përgjegjësi e Drejtorit të Përgjithshëm,

pasi ka marrë mendimin e Grupit Drejtues, që të emërojë dhe shkarkojë përgjegjësit e strukturave, të sektorëve, përgjegjësit e zyrave administrative, infermierët, drejtuesit e shërbimeve dhe/ose klinikave në përputhje të plotë me strukturën organizative të miratuar nga Këshilli i Administrimit;

- m) mund të propozojë në Këshillin e Administrimit emërimin dhe lirimin nga detyra të Drejtorit Mjekësor dhe Drejtorit Administrativ.
- n) organizon punën për shqyrtimin dhe zgjidhjen në kohë të kërkesave dhe ankesave të punonjësve;
- o) organizon kontrollet për veprimtarinë e shërbimeve mjekësore dhe administrative dhe merr vendimet përkatëse për përmirësimin e situatës;
- p) paraqet për miratim në Këshillin Administrativ planet afatgjata të zhvillimit të Spitalit ZKM
- q) i kërkon Presidentit të mbledhë Këshillin e Administrimit sa herë që rrethana të veçanta kërkojnë me urgjencë vendimin e tij;
- r) është përgjegjës për cilësinë e shërbimit të Spitalit ZKM.
- s) kontrollon punën dhe përgjigjet për ekzekutimin e buxhetit;
- t) propozon rregulloret e Spitalit ZKM dhe ndryshimet e tyre në aspekte të ndryshme të funksionit të tij;
- u) kontrollon dhe ndjek zbatimin e procedurave për përzgjedhjen, vendosjen, kualifikimin dhe specializimin e personelit të nivelit të lartë dhe të mesëm.

Neni 16 - Drejtori Mjekësor

1) Drejtori Mjekësor realizon përcaktimin dhe drejtimin e sistemit të qeverisjes klinike të spitalit. Ai është personalisht përgjegjës për organizimin tekniko-funksional të të gjitha shërbimeve të Spitalit ZKM, për standardet dhe performancën e shërbimeve shëndetësore.

2) Drejtori Mjekësor është mjek profesionist i licencuar, i cili regjistrohet rregullisht në regjistrin e mjekëve sipas normativës në Shqipëri. Emërohet nga Këshilli i Administrimit, edhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, dhe punon me kohë të plotë, raport i cili rregullohet me kontratë individuale, siç parashikohet për Drejtorin e Përgjithshëm. Atij i ndalohe kryerja e çdo veprimtarie të ushtrimit të profesionit në spitale të tjera, publike apo private.

3) Në ushtrimin e funksioneve të tij, Drejtori Mjekësor ndihmon Drejtorin e Përgjithshëm në përcaktimin e linjave strategjike dhe planifikimin për qëllime organizative dhe shëndetësore dhe shpreh detyrimisht mendim, për Drejtorin e Përgjithshëm, për aktet që kanë të bëjnë me çështjet në kompetencë të tij.

4) Drejtori Mjekësor, në përputhje me udhëzimet dhe objektivat e përcaktuara në Planet Strategjike të Spitalit, mbikëqyr dhe vepron në këto fusha ndërhyrjeje:

- a) Sigurisë në punë;
- b) Cilësia dhe akreditimi;
- c) Mjekësia e punës;
- d) Fizika e shëndetit në komponentin e lidhur me sigurinë;
- e) Shërbimi i inxhinierisë klinike

f) Menaxhimi i rrezikut klinik.

5) Për secilën nga fushat e sipërpërmendura dhe për lidhjet ndërmjet tyre e ato ndërmjet funksioneve të ndryshme, do të përgatiten rregullore të brendshme teknike, që përmbajnë detaje dhe procedura.

6) Drejtori Mjekësor, në kryerjen e funksionit koordinues të strukturave spitalore dhe garantimin e integritetit ndërmjet tyre, bashkëpunon me Drejtorin Administrativ në proceset e:

- a) planifikimit dhe organizimit.
- b) monitorimit të objektivave buxhetore.
- c) organizimin e pritjes së pacientëve, shërbimeve ambulatorë dhe shtrimeve në spital.

7) Në kuadër të udhëzimeve të përcaktuara nga kjo Rregullore si dhe nga Rregulloret teknike mjekësore, është përgjegjës për organizimin e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve dhe proceset e përkujdesjes shëndetësore dhe ka këto detyra kryesore:

- a) miraton procedurat dhe protokollet e veprimtarisë mjekësore në Spitalit ZKM.
- b) planifikon, organizon, drejton dhe kontrollon veprimtaritë për trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm të personelit shëndetësor.
- c) planifikon, organizon, drejton dhe kontrollon procesin e vlerësimit të performancës së personelit shëndetësor.
- d) planifikon, organizon, drejton dhe kontrollon procesin e identifikimit, zbatimit dhe monitorimit të standardeve profesionale.
- e) ndihmon Drejtorin Administrativ në hartimin e projekt- buxhetit për mbulimin e shpenzimeve të strukturave shëndetësore të Spitalit ZKM.
- f) kryeson proceset e përzgjedhjes dhe propozon tek Drejtori i Përgjithshëm emërimin dhe lirimin nga detyra të përgjegjësve të strukturave dhe të personelit tjetër shëndetësor të Spitalit ZKM.
- g) mbështet veprimtarinë e Komisionit Shkencor të Spitalit ZKM.
- h) organizon, drejton dhe monitoron proceset për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, për menaxhimin e ankesave ndaj shërbimit, për raportimin e incidenteve, për edukimin në vazhdim të profesionistëve si dhe për matjen e kënaqësisë së pacientit dhe stafit shëndetësor.
- i) organizon, mbikëqyr dhe përgjigjet për marrjen dhe zbatimin e masave të rekomanduara, për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve infektive.
- j) analizon rastet kur ndaj personelit mjekësorë të Spitalit ZKM-së kanë ardhur ankesa nga qytetarët për keq ushtrim të profesionit ose shkelje të etikës dhe kodit deontologjik mjekësor.
- k) siguron monitorimin dhe verifikimin e vëllimit dhe cilësisë së veprimtarisë së asistencës.
- l) siguron integritetin organizativ të sistemit informatik shëndetësor me atë të institucionit në tërësi;
- m) mbikëqyr drejtimin e shërbimit infermieror, të ndarë mundësisht në struktura operationale;
- n) kontrollon ngarkesën e punës dhe turneve të personelit shëndetësor;
- o) verifikon përshtatshmërinë e shpërndarjes së burimeve njerëzore, teknologjike dhe strukturore;
- p) kontrollon administrimin e produkteve farmaceutike, arkivimin dhe ruajtjen e të dhënave shëndetësore si dhe të kartelave klinike;

- q) organizon mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave statistikore shëndetësore dhe paraqitjen e raportit vjetor për ecurinë shëndetësore të spitalit;
- r) shpreh detyrimisht mendim për zgjedhjen dhe blerjen e aparaturave, pajisjeve dhe orendive mjekësore dhe të përshtatjes me teknologjitë bio-mjekësore;
- s) kontrollon aplikimin e rregullt të tarifave;
- t) raporton pranë autoriteteve kompetente për denoncimin e sëmundjeve ngjitëse të konstatuara në spital dhe për çdo raport tjetër të kërkuar nga ligji; u lëshon atyre që kanë të drejtë kopje të të dhënave mjekësore dhe çdo vërtetim tjetër shëndetësor në lidhje me pacientët e trajtuar në spital;
- u) i propozon Drejtorit të Përgjithshëm që të vlerësojë lidhjen e marrëveshjeve të specializuara në sektorin e shëndetësisë me organe dhe struktura publike ose private dhe me profesionistë individualë, në përputhje me dispozitat aktuale të ligjit.

8) Drejtori Mjekësor mund të pezullohet ose largohet nga detyra nga Këshilli i Administrimit të Fondacionit, edhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, me masë të motivuar, për arsye të rënda, për shkelje të ligjit ose të kontratës individuale ose për shkelje të direktivave të dhëna nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 17 - Drejtori Administrativ

- 1) Drejtori Administrativ ndihmon Drejtorin e Përgjithshëm në ushtrimin e funksioneve të tij dhe merr pjesë bashkë me të në drejtimin e Spitalit ZKM.
- 2) Drejtor Administrativ mund të emërohet një i diplomuar në disiplina që mundësojnë administrim të suksesshëm dhe që ka ushtruar drejtim administrativ në organizata ose struktura shëndetësore publike e private për të paktën 5 vjet.
- 3) Drejtori Administrativ ushtron funksionet e përcaktuara me Ligj dhe Rregulloret administrative, duke shfrytëzuar strukturat organizative që ka në vartësi.
- 4) Drejtori Administrativ ndan përgjegjësitë e drejtpërdrejta funksionale ndaj njësive organizative të vendosura në drejtimin e tij për realizimin e objektivave të përgjithshme dhe specifike të subjektit.
- 5) Drejtori Administrativ emërohet nga Këshilli i Administrimit, edhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.
- 6) Drejtori Administrativ, kur thirret, merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të Administrimit me funksione këshilluese.
- 7) Drejtori Administrativ i jep një mendim të detyrueshëm Drejtorit të Përgjithshëm për dokumentet që kanë të bëjnë me çështjet në kompetencën e tij/saj.
- 8) Marrëdhënia e punës e Drejtorit Administrativ është ekskluzive dhe rregullohet me kontratë të caktuar, siç parashikohet për Drejtorin e Përgjithshëm dhe Drejtorin Mjekësor.
- 9) Drejtori Administrativ drejton shërbimet e sektorit duke iu referuar veçanërisht aspekteve juridiko-administrative, ekonomike-financiare dhe tekniko-logjistike, duke siguruar funksionin e duhur mbështetës për aktivitetet klinike dhe asistuese të spitalit.

10) Ai koordinon veprimtaritë e prokurimit dhe menaxhimit të blerjeve dhe logjistikës, mirëmbajtjen e zakonshme dhe të jashtëzakonshme të strukturave dhe impianteve, duke përcaktuar strategjitë e blerjes, funksionimit dhe mirëmbajtjes, që bëjnë të mundur shfrytëzimin e sinergjive të menaxhimit dhe kostove të furnizimit.

11) Për mirëfunksionimin e Spitalit ZKM në aspektin e administrimit, Drejtori Administrativ ka këto detyra kryesore:

- a) organizon procesin e menaxhimit dhe administrimit financiar të Spitalit ZKM, duke siguruar transparencë.
- b) paraqet për miratim në Drejtorinë e përgjithshme tarifat e shërbimeve spitalore të Spitalit ZKM, pas një vlerësimi të përshtatshëm nga zyrat kompetente.
- c) planifikon, organizon, drejton dhe kontrollon mbarëvajtjen e strukturave logjistike, me fokus përkujdesjen, mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e infrastrukturës, pajisjeve dhe sistemeve teknike të Spitalit ZKM.
- d) planifikon, organizon, drejton dhe kontrollon mbarëvajtjen e marrëdhënieve me kontraktorët.
- e) harton dhe paraqet tek Drejtori i Përgjithshëm planet buxhetore të Spitalit ZKM, bazuar edhe në propozimet e Drejtorit Shëndetësor për pjesën përkatëse.
- f) kryeson procesin e përzgjedhjes dhe propozon tek Drejtori i Përgjithshëm emërimin e personelit administrativ të Spitalit ZKM.
- g) harton dhe propozon rregullat dhe procedurat për prokurimin, blerjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme.
- h) paraqet për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm kontratat për blerjen e shërbimeve dhe materialeve, në përputhje me rregullat, procedurat dhe buxhetin e miratuar nga Këshilli i Administrimit.
- i) mbikëqyr procesin e zbatimit të kontratave të mbështetjes me mallra dhe shërbime.
- j) përgatit projekt-buxhetin e Spitalit ZKM në bashkëpunim me strukturat e tjera të spitalit dhe e paraqet tek Drejtori i Përgjithshëm.
- k) përgatit bilancin kontabël të Spitalit ZKM dhe analizën që shoqëron llogarinë vjetore.
- l) siguron përdorimin me efektivitet të burimeve financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- m) monitoron fondet e akorduara me buxhetin vjetor për Spitalin ZKM.
- n) kontrollon realizimin e buxheteve për çdo zë dhe paraqet çdo muaj raportin financiar të Spitalit ZKM tek Drejtori i Përgjithshëm.
- o) mbikëqyr menaxhimin financiar dhe kontrollin e pasqyrave financiare në Spitalin ZKM.
- p) përgatit udhëzime e metodologji për llogaritjen e kostove të shërbimeve të ofruara nga institucioni.
- q) kontrollon realizimin dhe arkëtimin në kohë të të ardhurave të Spitalit ZKM.
- r) drejton procesin e inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme dhe inventarin ekonomik në bashkëpunim me strukturat e tjera të Spitalit ZKM.
- s) drejton procesin e nxjerrjeve jashtë përdorimit të mjeteve kryesore dhe të materialeve të konsumit jashtë afateve të përdorimit. Ndjek dhe monitoron në mënyrë periodike skadencat e barnave dhe materialeve mjekësore dhe, bazuar në situatën e gjendur, për një mirë përdorim dhe miradministrim korrekt, merr masa për administrimin dhe shpërndarjen e tyre sipas radhës së skadencave.

- t) informohet për zbatimin e kontratave të lidhura ndërmjet Spitalit ZKM dhe të tretëve, kryen vlerësim në lidhje me to duke u konsultuar me Drejtorin e Përgjithshëm.
- u) luan rol aktiv dhe bashkëpunues në planifikimin për nevojat e Spitalit ZKM për bazë materiale, medikamente dhe materiale mjekësore.
- v) Pret, pranon dhe bashkëpunon, duke vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, çdo subjekti apo personi të autorizuar dhe të ngarkuar për të kryer auditim/kontroll/inspektim në Spitalit ZKM, të bazuar në aktet ligjore, nënligjore dhe administrative në fuqi.

12) Drejtori Administrativ ndihmohet nga zyrat përkatëse në realizimin e detyrave dhe objektivave të tij.

12) Drejtori Administrativ mund të pezullohet ose të lirohet nga detyra nga Këshilli i Administrimit të Fondacionit edhe me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, me një masë të motivuar, për arsye të rënda, për shkelje të ligjit ose të kontratës individuale ose për shkelje të direktivave të dhëna nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 18 - Koordinator i përgjithshëm (Kryeinfermieri i Përgjithshëm)

1) Koordinator i përgjithshëm (Kryeinfermieri i Përgjithshëm) bën pjesë në Grupin Drejtues të Spitalit. Koordinator i përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Mund të emërohet si Koordinator i përgjithshëm një i diplomuar që ka një diplomë master në shkencë infermieristike dhe përvojë më shumë se pesë vjet në funksione drejtuese në sektorin shëndetësor.

2) Pozicioni i Koordinatorit të Infermierisë është elementi qendror për motivimin e grupit në fushën e kujdesit infermieror. Koordinator duhet të stimulojë operatorët e tij të punojnë duke u kujdesur për organizimin, zbatimin e shërbimit infermieror në të gjithë spitalin dhe respektimin e parimeve etike, duke përdorur eksperiencën e tij, njohuritë e fituara në ecurinë formuese dhe kompetencat në sistemet informative në dispozicion.

3) Koordinator i përgjithshëm planifikon, menaxhon, zbaton, monitoron dhe vlerëson ndërhyrjen infermiore, garanton zbatimin e saktë të recetave diagnostiko-terapeutike; vepron si individualisht ashtu edhe në bashkëpunim me profesionistë të tjerë shëndetësorë e sociale; përdor, kur është e nevojshme, stafin mbështetës, të përcaktuar nga Grupi Drejtues.

4) Koordinator i përgjithshëm në thelb mban një pozicion drejtues, duke kryer detyra mbikëqyrëse. Ai është përgjegjës për menaxhimin, organizimin dhe planifikimin strategjik të njësisë së infermierisë brenda Spitalit ZKM.

5) Detyrat e tij më hollësisht janë të përshkruara në Rregulloren Teknike Mjekësore të Spitalit ZKM.

Neni 19 - Këshilli i Etikës

1) Komisioni i Etikës është një organ i pavarur, pa kufizime vartësie hierarkike ndaj spitalit apo autoriteteve të tjera, i krijuar sipas kritereve ndërdisiplinore, nga ekspertë të fushës së klinikës,

jurisprudencës, teologjisë, filozofisë morale dhe bio-etikës, të emëruar drejtpërdrejt nga Këshilli i Administrimit nga radhët e personaliteteve të spikatur në këto fusha vendas e të huaj.

2) Komisioni i Etikës përbëhet nga pesë anëtarë të zgjedhur nga specialistët e fushave të përshkuara në paragrafin 1. Kryetari zgjidhet nga anëtarët në mënyrë unanime.

3) Komisioni i Etikës ka për detyrë të:

- a) të sigurojë mbrojtjen e të drejtave, sigurisë dhe mirëqenies së të gjithë personave të përfshirë në testime klinike, me vëmendje të veçantë për subjektet vulnerabël; për këtë qëllim, ai ka për detyrë të analizojë, sipas kritereve të praktikës së mirë klinike, profilet shkencore dhe etike të të gjitha protokolleve të testeve të propozuara brenda Spitalit ZKM ose nga propozues të jashtëm dhe shpreh detyrimisht mendim në formë të shkruar dhe të motivuar, mendim i cili është kushtëzues;
- b) të nxisë vlerat humane dhe të krishtera në Spitalin ZKM në dokumentet themelore, praktikën dhe kërkimin klinik e shkencor.
- c) të shqyrtojë, me kërkesë të personelit shëndetësor ose të pacientëve ose përfaqësuesve të tyre, raste ose probleme klinike që lidhen me veprimtarinë e asistencës klinike të kryer në Spitalit ZKM dhe të shprehë mendime jodetyruese dhe rekomandime;
- d) nxit hartimin e dokumenteve për çështjet bio-etike dhe udhëzimeve për promovimin e cilësisë së praktikës klinike, për humanizmin e mjekësisë dhe për të nxitur të kuptuarit më të mirë të domethënies dhe praktikës së mjekësisë;
- e) të realizojë dhe promovojë mundësi trajnimi mbi aspektet etike të praktikës dhe kërkimit bio-mjekësor, për profesionistët shëndetësorë dhe publikun.
- f) i propozon për miratim Këshillit të Administrimit Kodin e Etikës të Spitalit ZKM.
- g) analizon dhe rekomandon vendimmarrjet e nevojshme për çështjet peshë të posaçme etike nga fusha e kërkimit shkencor dhe e praktikës klinike.

4) Veprimtaria e Këshillit të Etikës bazohet në Rregulloren e tij, e cila miratohet nga Këshilli i Administrimit.

Neni 20 – Këshilli Shkencor

1) Kërkimi shkencor është instrumenti kryesor që i mundëson Spitalit ZKM pjesëmarrjen aktive në krijimin e të ardhmes. Spitali ZKM nuk kufizohet vetëm në zbatimin e arritjeve më të reja të shkencës dhe të teknologjisë, por angazhohet aktivisht në projektimin e një të nesërmeje më të drejtë dhe më të kujdesshme ndaj kujdesit për të sëmurin.

2) Për trajtimin profesional të çështjeve të kërkimit shkencor, në Spitalin ZKM ngrihet dhe funksionon Këshilli Shkencor, si një organ i nivelit të lartë profesional, i cili ushtron edhe funksione këshilluese për autoritetet drejtuese të spitalit.

3) Përbërja e Këshillit Shkencor përcaktohet me vendim të Këshillit të Administrimit. Si anëtarë të Këshillit Shkencor përzgjidhen personalitete të spikatur nga fusha e shëndetësisë nga vendi dhe nga komuniteti shkencor ndërkombëtar.

4) Kompetenca kryesore të Këshillit Shkencor janë:

- a) Diskuton dhe shpreh opinion për planet e kërkimit shkencor dhe klinik të Spitalit ZKM, pas marrjes së pëlqimit edhe nga Këshilli i Etikës.
- b) Diskuton dhe shpreh opinion për planet e përbashkëta të kërkimit shkencor dhe të praktikës klinike që vijnë si propozim i Spitalit ZKM dhe UKZKM, apo mes Spitalit ZKM dhe palëve të treta.
- c) Organizon, zhvillon dhe jep stimuj apo çmime për ekselencën në fushën e kërkimit shkencor në mjekësi, në bazë të fondeve, të rregullave dhe kritereve të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm.
- d) Rishikon dhe jep rekomandime për miratimin e politikave të lidhura me përmirësimin e cilësisë së shërbimeve mjekësore dhe të kërkimit shkencor.

5) Veprimtaria e Këshillit Shkencor kryhet në bazë të Rregullores së tij, e cila miratohet nga Këshilli i Administrimit.

Neni 21 - Asistenca Shpirtërore në Spitalin ZKM

- 1) Ndihma shpirtërore në Spitalin ZKM sigurohet nga një shërbim i dedikuar, i përcaktuar me pëlqimin e Këshillit të Administrimit të Fondacionit ZKM dhe i përbërë nga operatorë të propozuar nga Kongregata e Bijve të Zojës së Papërlyer sipas procedurave të veta, të emëruar nga Ordinari i vendit.
- 2) Kujdesi baritor ndaj shëndetit zhvillohet sipas linjës së Ordinarit të vendit.
- 3) Spitali ZKM siguron që punonjësit e kujdesit baritor të marrin kompensim të drejtë ekonomik në lidhje me punën e kryer. Për qarkullimin e operatorëve duhet të informohet paraprakisht Grupi Drejtues i Spitalit NSBC.

Neni 22 - Dispozitat përfundimtare

1. Për çdo gjë që nuk shprehet në këtë Rregullore zbatohen dispozitat e Rregullores Administrative dhe Rregullores Tekniko-Mjekësore të Spitalit ZKM të miratuara nga Këshilli i Administrimit. Dispozita të tjera që nuk pasqyrohen në këtë rregullore do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Administrimit sipas sistemit ligjor shqiptar.
2. Rregullorja hartohet në gjuhët italiane dhe shqipe. Në rast të paqartësive mes dispozitave apo gjuhëve do të kërkohet interpretimi nga Këshilli i Administrimit.

Miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit me datë 08.06.2022.